

Statistikat e transportit*

Nëntor 2022

Tiranë, më 22 Dhjetor 2022: Statistikat e Transportit sipas llojeve, për muajin Nëntor 2022, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 205,2 ton, duke u rritur me 7,7 % në krahasim me Nëntor 2021.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, është 269.8 mijë ton, duke u ulur me 28,0 % krahasuar me Nëntor 2021.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.801 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 30,2 %, krahasuar me Nëntor 2021.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton*
Nëntor 2021	374.958	1.383	190,4
Nëntor 2022	269.824	1.801	205,2
Ndryshimi vjetor (%)	-28,0	30,2	7,7
Janar-Nëntor 2021	4.465.410	23.477	1.835,8
Janar-Nëntor 2022	3.531.334	18.244	1.888,1
Ndryshimi vjetor (%)	-20,9	-22,3	2,8

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, situata e Statistikave të Transportit sipas llojeve, paraqitet si në vijim:

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 1.888,1 ton, duke u rritur me 2,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3.531,3 mijë ton, duke u ulur me 20,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 18.244 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 22,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Për publikim 22/12/2022

Vijon

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Nëntor 2021	19	2.124	9.299
Nëntor 2022	18	2.826	11.818
Ndryshimi vjetor (%)	-5,3	33,1	27,1
Janar-Nëntor 2021	19	23.926	118.805
Janar-Nëntor 2022	18	36.044	201.447
Ndryshimi vjetor (%)	-5,3	50,6	69,6

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në Nëntor 2022, treguesit mbi numrin e fluturimeve dhe numrin e pasagjerëve, paraqiten si në vijim:

Numri i fluturimeve është 2.826 duke u rritur me 33,1 %, krahasuar me muajin Nëntor 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 390.748 pasagjerë, duke u rritur me 70,0 %, krahasuar me Nëntor 2021.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 43.519 pasagjerë. Krahasuar me Nëntor 2021, ky tregues është rritur me 28,4 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 165 pasagjerë. Krahasuar me Nëntor 2021, ky tregues është ulur me 84,0 %.

Në muajin Nëntor 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 89,9 % të transportit gjithsej.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, treguesit mbi numrin e pasagjerëve, paraqiten si në vijim:

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 4.830.165 pasagjerë, duke u rritur me 81,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjë detare 1.291.771 pasagjerë, duke u rritur me 60,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 10.481 pasagjerë, duke u ulur me 54,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Tab. 3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Nëntor 2021	1.031	33.881	229.904
Nëntor 2022	165	43.519	390.748
Ndryshimi vjetor (%)	-84,0	28,4	70,0
Janar-Nëntor 2021	23.252	803.657	2.656.935
Janar-Nëntor 2022	10.481	1.291.771	4.830.165
Ndryshimi vjetor (%)	-54,9	60,7	81,8

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Nëntor 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 773,4 mijë ton ku 55,4 % e tyre u transportua me det.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 8.257,4 mijë ton ku 54,9 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Nëntor 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 54,1 %, me det 45,8 % dhe 0,1 % me ajër.

Volumi i mallrave të eksportuara me det është rritur 19,1 %, ndërsa me tokë është ulur me 17,8 % dhe me ajër është ulur me 50,4 % krahasuar me Nëntor 2021.

Tab. 4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit


Periudha	Eksport (ton)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Nëntor 2021	142.883	-	244.526	33	30
Nëntor 2022	170.176	-	200.891	16	128
Ndryshimi vjetor (%)	19,1	0,0	-17,8	-50,4	321,0
Janar-Nëntor 2021	1.582.942	961	2.421.188	199	1.091
Janar-Nëntor 2022	1.602.321	1.824	1.999.384	216	689
Ndryshimi vjetor (%)	1,2	89,8	-17,4	8,6	-36,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 55,5 %, me det 44,4 % dhe 0,1 % me hekurudhë.

Volumi i mallrave të eksportuara me hekurudhë është rritur me 89,8 %, me ajër është rritur me 8,6 % dhe me det është rritur me 1,2 %, ndërsa volumi i mallrave të eksportuara me tokë është ulur me 17,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Nëntor 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 64,2 %, me tokë 34,8 % dhe të tjera 1,0 %. Volumi i mallrave të importuara me ajër është rritur me 29,6 %, ndërsa volumi i mallrave të importuara me det është ulur me 11,1 % dhe me tokë është ulur me 18,1 % krahasuar me Nëntor 2021.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (ton)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Nëntor 2021	290.276	592	170.644	101	4.248
Nëntor 2022	258.049	-	139.792	131	4.175
Ndryshimi vjetor (%)	-11,1	-100,0	-18,1	29,6	-1,7
Janar-Nëntor 2021	3.048.829	30.893	1.862.104	1.415	30.028
Janar-Nëntor 2022	2.930.749	2.780	1.682.942	1.193	35.337
Ndryshimi vjetor (%)	-3,9	-91,0	-9,6	-15,7	17,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTA

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 63,0 %, me tokë 36,2 %, me hekurudhë 0,1 % dhe të tjera 0,7 %. Volumi i mallrave të importuara me hekurudhë është ulur me 91,0 %, me ajër 15,7 %, me tokë 9,6 % dhe me det është ulur me 3,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transporti tokësor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash